

Krye 41.

- 1 Edhe passi shkuanë dy vjet të-tërë, Fa-
- raoni pa një ëndërrë; edhe na tek po rrinte
- 2 përënë lumit. Edhe na shtatë lopë të-bukura
- e të-majme tek po ngjiteshinë nga lumi, e
- 3 po kullotinë ndëpër kallamet. Edhe na shtatë
- lopë të-tjera tek po ngjiteshinë pas atyre nga
- lumi, të-shëmtuara e të-ligura, edhe qëndru-

anë për anë lopëvet të-tjera mbi buzët të lumit. Edhe të shtatë lopët' e-shëmtuara e të ligura hëngrë të shtatë lopët' e-bukura e të-majme. Atëhere Faraoni usgjua.

5 Edhe si e zuri gjumi përsëri, pa ëndërrë për-së-dyti; edhe na shtatë kallinj gruri të-plotë e të-mirë tek po delninë prej një kallami. Na edhe shtatë kallinj të-tjerë të hoj e të-djegurë nga era e djellit tek po mbini-

7 në pas atyre. Edhe kallinj' e-hoj përpinë të shtatë kallinj' e-majm e të-plotë. Edhe Faraoni usgjua, edhe na tek ishte ëndërrë.

8 Edhe ndë mëngjës shpirti i ati ishte i-trumbulluarë; edhe dërgoj e thirri gjithë magjistaret' e Egjyptësë, edhe gjithë të-diturit' e asaj. Edhe Faraoni u tregoj atyreve ëndërrat' e tia; po nukë kishte asndonjë që t' j'a

9 sgithte Faraonit. Atëhere i-pari verëkthenjës i foli Faraonit, e tha, Sot po më kujtonenë

10 fajet' e mi. Faraoni ishte zëmëruarë kundër shërbëtorëve të ti, edhe më vuri ndë burkt ndë shtëpit të të-parit ruajtës të mbretit, mua

11 edhe të-parinë bukëpjekës. Edhe mbë një natë pamë ëndërrë, un' edhe ay; pamë ëndërrë sicili pas të-sgidhurit të ëndërrës' së tij.

12 Edhe atje bashkë me ne ishte një djalosh, një Ebre, shërbëtuar i të-parit të ruajtësve; edhe j'a treguam' atij, edhe na i sgidhi ëndërratë t' ona; gjithë-sicilit j'a sgidhi pas

13 ëndërrës' s' ati. Edhe sikundër na i sgidhi,

ashtu gjau; un' uvushë ndë punët t' ime, edhe ay uvar.

14 Atëhere Faraoni dërgoj e thirri Josifnë, edhe e prunë atë me të-çpejtë nga burgu; edhe ay urruajt, e ndërroj rrobat' e tia, e

15 erdhi te Faraoni. Edhe Faraoni i tha Josifit, Pashë një ëndërrë, edhe nukë ka kush të m'a sgithej; edhe unë dëgjova të thonë për ty, se ti posa që dëgjon një ëndërrë munt t'a sgithej.

16 Edhe Josifi i upërgjeh Faraonit, dyke thënë, Jo unë, po Perëndia dot' i apë Faraonit një të-sgidhurë shpëtimi.

17 Edhe Faraoni i tha Josifit, Ndë ëndërrët t' ime, na tek po rrinjam mbi buzët të lumit; edhe na shtatë lopë të-majme e të-bukura tek po ngjiteshinë nga lumi, e po kullo-

19 llotinë ndëpër kallamet; Edhe na shtatë lopë të-tjera tek po ngjiteshinë pas atyreve, të-dobëta e shumë të-shëmtuara e të-ligura kaqë, sa të-këtilla nga të-liguritë s' kam parë

20 kurrë ndë gjithë dhet t' Egjyptësë; Edhe të shtatë lopët' e-ligura e të-shëmtuara hëngrë

21 të shtatë lopët' e-para, të-majmetë; Edhe si i hëngrë ato, nukë munt të çquhej, se i kishinë ngrënë; po ishinë edhe prapë të-shëmtuara si ndë kryet. Atëhere usgjova. Pastaj

22 pashë ndë ëndërrët t' ime, edhe na shtatë kallinj tek po dilninë prej një kallami, të-

23 plotë e të-mirë; Edhe na shtatë kallinj të-

tjerë të-thatë, e të-hoj e të-djegurë nga era
 24 e djellit, tek po mbininë pas atyreve. Edhe
 kallinjt' e-hoj përpinë të shtatë kallinjt' e-mi-
 rrë. Edhe u'a rrëfeva magjistarëvet; po nukë
 kishte asndonjë që të muntte të m' i sgithte.
 25 Edhë Josifi i tha Faraonit, Ëndërra e Fa-
 raonit është një; Perëndia i dëfteu Faraonit
 26 sa ka për të bërë. Të shtatë lopët' e-mira
 janë shtatë vjet; edhe të shtatë kallinjt' e-
 27 mirë janë shtatë vjet. Edhe të shtatë lopët'
 e-dobëta e të-shëmtuara që ngjiteshinë pas
 atyre janë shtatë vjet si edhe të shtatë ka-
 llinjt' e-sbrazëtë e të-djegurë nga era e dje-
 llit; këta dotë jenë shtatë vjet zie *për bukë*.
 28 Këjo është gjëja që i thashë Faraonit; Perën-
 29 dia i dëfteu Faraonit sa ka për të bërë. Na
 tek vinjënë shtatë vjet me të-madhe plotësi
 30 *drithërash* ndë gjithë dhet të Egjypësë; Edhe
 pas atyre dotë vinjënë shtatë vjet zie; edhe
 gjithë të-plotëtë dotë harronetë ndë dhet të
 Egjyptësë, edhe zia dotë prishnjë dhenë;
 31 Edhe nukë dotë njihetë të-plotëtë ndë dhet,
 për punë t' asaj zie që dotë vinjë pas; sepse
 32 dotë jetë fort e-rëndë. Edhe të-dukurit' e ën-
 dërrësë dy herë te Faraoni tregon, se *këjo*
 gjë është urdhëruarë nga Perëndia, edhe *se*
 33 Perëndia për-së-çpejti dot'a bënjë këtë. Ta-
 shi pra Faraoni letë sgjethnjë një njeri të-
 mënçim e të-urtë edhe let'a vërë atë mbi
 34 dhet të Egjyptësë. Faraoni let'a bënjë këtë, e

let' urdhëronjë të-parë mbi dhet; edhe letë
 marrë të-pesëtënë *nga të-ardhurat' e* dheut të
 Egjyptësë, ndë të shtatë vitet të të-plotit.
 35 Edhe letë mbledhënë gjithë të-ngrënat' e kë-
 tyre të shtatë vjetve të-mirë që vinjënë; edhe
 letë kenë mbyllurë grurë ndënë dorët të Fa-
 raonit, për ushqim ndë qytetet, edhe let'a
 36 ruanjënë. Edhe ushqimetë të ruhenë për dhe-
 në për ata të shtatë vjett' e zisë që dotë vi-
 njënë pas ndë dhet t' Egjyptësë; që të mos
 humbasë vëndi nga zia.
 37 Edhe fjala i pëlqeu Faraonit, edhe gjithë
 38 shërbëtorëvet t' atij. Edhe Faraoni u tha shër-
 bëtorëvet të ti, A munt të gjejmë njeri si kë-
 39 të, njeri që ka frymën' e Perëndisë? Edhe
 Faraoni i tha Josifit, Me-qënë-që Perëndia të
 dëfteu këto të-gjitha, nukë ka asndonjë *tje-*
 40 *tërë* njeri kaqë të-mënçim e të-urtë sa ti. Ti
 dotë jesh mbi shtëpit t' ime, edhe pas fja-
 lësë s' ate gjithë gjindja ime dotë sundohe-
 të; Vetëmë ndë front dotë jenë më i-math se ti.
 41 Edhe Faraoni i tha Josifit, Na tek të vu-
 42 ra përmbi gjithë dhen' e Egjyptësë. Edhe Fa-
 raoni nxori unazën' e ti me vulë nga dora e
 tij, e e vuri ndë dorët të Josifit, edhe i ve-
 shi ati rroba prej liri të-hollë, edhe i vuri
 43 një qafore të-artë rreth qafës' s' atij. Edhe e
 hipi atë mbi të-dytët qerre të tij; edhe lëçis-
 ninë përpara ati, Bini mbë gjunjë; edhe e
 44 vuri atë përmbi gjithë dhen' e Egjyptësë. E-

dhe Faraoni i tha Josifit, Unë jam Faraoni, edhe pa ty asndonjë s' ka për të ngriturë dorën' e ti a këmbën' e ti mbë gjithë dhen' e
45 Egjyptësë. Edhe Faraoni e quajti emërin' e Josifit Zafnath-paneah¹⁾; edhe i dha ati për grua Asenathënë, të bijën' e Poti-ferajt, priftit të Onit. Edhe Josifi dolli ndëpër gjithë dhet të Egjyptësë.

46 Edhe Josifi ishte tri-dhjetë vjeç, kur doli përpara Faraonit, mbretit të Egjyptësë; edhe Josifi dolli që përpara Faraonit, edhe vate ndëpër gjithë dhet të Egjyptësë.

47 Edhe ndë të shtatë vjett të të-plotit dheu
48 dha grurë me dorë plot. Edhe mblodhi gjithë drithëratë që ubënë ndë dhet të Egjyptësë ndë të shtatë vjett të të-plotit, edhe i mbylli ndëpër qytetet; drithërat' e aravet rrotullë
49 çdo qyteti i vuri nd' atë. Edhe Josifi mblodhi grurë posi rërën' e detit, kaqë shumë, sa pushoj t'a matnjë; sepse s' kishte dot të-maturë.

50 Edhe Josifit i lintnë, përpara se të vinjënë vjett' e zisë, dy djem, të-cilëtë j'a polli Asenatha, e bija e Poti-ferajt, priftit të Onit.
51 Edhe Josifi j'a vuri emërinë djalit të-parë Manasseh²⁾; sepse, *tha*, Perëndia më bëri të harroj gjithë mundimet' e mi, edhe gjithë shtëpin' e t'im et. Edhe të-dytit j'a vuri emërinë Efraim³⁾; sepse, *tha*, Perëndia më shtoj ndë dhet të shtrëngimit t'im.

¹⁾ Ay që njeh të-fshehuratë. ²⁾ Të-harruarë. ³⁾ Të-shtuarë.

53 Edhe shkuanë të shtatë vjett' e të-plotit
54 që ubë ndë dhet të Egjyptësë. Edhe zunë të vijnë të shtatë vjett' e zisë, sikundrë pat thënë Josifi; edhe ubë zi ndëpër gjithë vëndet; po ndë gjithë dhet të Egjyptësë kishte buke.
55 Edhe kur e shtrëngoij uria gjithë dhen' e Egjyptësë, gjindja i klithi Faraonit për bukë. Edhe Faraoni u tha të gjithë Egjyptianëvet, Shkoni te Josifi; *edhe* bëni ç' t' u thotë ay.
56 Edhe ishte një zi mbi gjithë faqen' e dheut. Edhe Josifi hapi gjithë grunarëtë, edhe u shiste *drithë* gjithë Egjyptianëvet; edhe zia po
57 rëndonej mbi dhen' e Egjyptësë. Edhe nga gjithë vëndetë vininë ndë Egjyptë te Josifi për të blerë drithë; sepse zia po rëndonej mbi gjithë dhenë.

Krye 42.

1 Edhe Jakobi pa se gjëndej drithë ndë Egjyptë; edhe Jakobi u tha të bijet, Ç' shikon
2 ni njëri jatinë? Edhe *tha*, Na tek dëgjova se gjëndetë drithë ndë Egjyptë; sbritni atje, edhe blini për ne andej, që të rrojmë, e të mos vdesëmë.

3 Edhe sbritnë të dhjetë vëllezërit' e Josifit
4 për të blerë drithë nga Egjypta. Po Beniamininë, të vëllan' e Josifit, Jakobi nuk' e dërgoj bashkë me të vëllezëritë; sepse *tha*, Mos i gjasë ndonjë e-keqe.

5 Edhe të bijt' e Israilitit erthnë për të ble-

- rë drithë ndër mest t' atyreve që vininë *atje*;
 6 sepse ishte zi ndër dhet të Hanaanit. Edhe Josifi ishte qivernitar i vëndit; ay i shiste gjithë gjindjes' së vëndit; erdhë pra të vëllezërit' e Josifit, edhe i unjnë ati kryet' e tyre gjer përdhe.
- 7 Edhe Josifi, kur pa të vëllezëritë, i njohu; po ubë si i-huaj mbë ata edhe u fliste atyre ashpërë; edhe u tha atyre, Nga vini? Edhe ata thanë, Nga dheu i Hanaanit, për të blerë drithë.
- 8 Edhe Josifi njohu të vëllezëritë, po ata nuk' e njohën atë. Edhe Josifit i erdhë ndër mëntt ëndërratë që pat parë për ata, edhe u tha atyre, Ju jeni përgjonjës; kini ardhurë për të shikuarë shtegjet' e vëndit.
- 10 Edhe ata i thanë, Jo, zoti im; po *neve* shërbëtorët' e tu kemi ardhurë për të blerë drithë. Neve që të-gjithë jemi bij të një njeriu; jemi njerës të-mirë; shërbëtorët' e tu nukë janë përgjonjës.
- 12 Edhe ay u tha atyre, Jo, po keni ardhurë për të shikuarë shtegjet' e vëndit.
- 13 Edhe ata thanë, *Neve* shërbëtoret' e tu jemi dy-mbë-dhjetë vëllezër, të bijt' e një njeriu ndër dhet të Hanaanit; edhe na më i-vogëli *tek gjëndetë* sot me atinë t' ënë, edhe tjetëri nuk' është.
- 14 Edhe Josifi u tha atyre, Këjo është ajo që
 15 u thashë, dyke thënë, Ju jini përgjonjës. Me

- këtë dotë provohi; për jetët të Faraonit *u bënj be*, se nukë dotë dilni së-këtejmi, ndër mos
 16 arthtë këtu vëllaj juaj më i-vogëli. Dërgoni një nga ju, edhe letë bjerë vëllanë t' uaj; edhe ju dotë mbetni të-lidhurë, gjersa të provonenë fjalëtë tuaj, ndër thoni të-vërtetënë; po ndër mos, për jetët të Faraonit, me të-vërtetë jeni përgjonjës.
- 17 Edhe i vuri ata ndënë ruajtje tri dit.
 18 Edhe të-tretënë ditë Josifi u tha atyre, Bëni këtë, edhe dotë rroni; *sepse* unë kam frikë
 19 nga Perëndia. Ndë jeni njerës të-mirë, njëri nga vëllezëritë t' uaj dotë mbetetë i-lidhurë
 20 ndër burkt aty ku jini; Po ju shkoni, e merrni drithë për zin' e shtëpivet t' uaj; edhe bimë-ni vëllanë t' uaj më të-vogëlinë; kështu dotë vërtetonenë fjalëtë t' uaj, edhe nukë dotë vdisni. Edhe ata bënë kështu.
- 21 Edhe i thanë njëri jatërit, Me të-vërtetë jemi fajtorë për vëllanë t' ënë, sepse pamë shtrëngimn' e shpirtit t' ati, kut na lutej, edhe nuk' i dëgjuamë; përandaj erdhi ky shtrëngim mbi ne.
- 22 Edhe Rubini upërgjeq atyre, e u tha, A nuk' u thashë juve *atëhere*, dyke thënë, Mos bëni faj kundrë djalit, edhe nukë më dëgjuatë? përandaj na tek kërkonetë gjaku i ati.
- 23 Edhe ata nukë dininë se i kupëtonte Jo-
 24 sifi; sepse flisninë me gjuhëpërkthenjës. Edhe *Josifi* uhoq që për'an' atyreve, edhe qau; edhe

prapë ukthye tek ata, e u fliste; edhe mori prej atyre Simeoninë, edhe e lidhi përpara syvet t' atyre.

- 25 Atëhere Josifi urdhëroj t'u mbushninë atyre thasëtë me drithë, edhe t' i kthenin' ergjëndinë gjithë-sicilit ndë thest t' ati, edhe t' u epninë të-ngrënë për udhësë; edhe ubë
- 26 kështu ndër ata. Edhe ata si ngarkuanë drithët' e tyre mbi gomarët, shkuanë s' andejmi.
- 27 Edhe kur njëri nga ata hapi thesin' e ti, që t' i epte të-ngrënë gomarit të ti ndë vëntt që kishinë rënë, pa ergjëndin' e tij, edhe na
- 28 tek ishte ndë grykët të thesit të ti. Edhe u tha të vëllezërvet, Ergjëndi im m' udha prapë, edhe na tek është ndë thest t' im; edhe uhabit zëmëra e atyre, edhe ufrikësuanë, edhe thanë njëri jatërit, Ç' është këjo që na bëri Perëndia?
- 29 Erdhë pra te Jakobi, tek i ati i tyre, ndë dhet të Hanaanit, edhe i rrëfyan' ati gjithë sa
- 30 u kishinë gjarë, edhe thanë, Ay njeriu, i zot' i vëndit, na foli vrazhëtë, edhe na mori për
- 31 përgjonjës të vëndit. Edhe i tham' atij, se Jemi
- 32 njerës të-mirë; nukë jemi përgjonjës; Jemi dy-mbë-dhjetë vëllezër, të bijt' e atit t' ënë; njëri nuk' është; edhe m' i-vogëli është tashi bashkë me atinë t' ënë ndë dhet të Hanaa-
- 33 nit. Edhe ay njeriu, i zot' i vëndit, na tha, Me këtë dot' e njoh se jeni njerës të mirë; lini bashkë me mua njërinë nga vëllezëritë

- t' uaj, edhe merrni drithë për zin' e shtëpivet
- 34 t' uaj, edhe shkoni; Edhe bir-më-ni vëllanë t' uaj më të-vogëlinë; atëhere dot' e njoli, se nukë jeni përgjonjës, po se jini *njerës* të-mirë; edhe dot' u ap prapë vëllanë t' uaj, edhe dotë tregëtoni ndë këtë vënt.
- 35 Edhe kur po sbrasninë thasët' e tyre, na gjithë-sicilit e-lidhura e ergjëndit tek ishte ndë thest t' ati; edhe kur panë ata edhe i at' i atyreve të-lidhurat' e ergjëndit të tyre, ufrikësuanë.
- 36 Edhe Jakobi, i at' i atyreve, u tha atyre, Ju më latë pa djem; Josifi nuk' është, edhe Simeoni nuk' është; doni të merrni edhe Veniaminë; të-gjitha këto erthnë mbi mua.
- 37 Edhe Rubini i tha t' et, dyke thënë, Vra-i të dy bijt' e mi, ndë mos t'a prufsha ty atë; ep-m'a ndë dorë, edhe unë dotë t'a bje përsëri.
- 38 Edhe ay tha, S' ka për të sbriturë im bir bashkë me jy; sepse i vëllaj vdiq, edhe ay mbeti vetëmë; edhe ndë i gjaftë ati ndonjë e-keqe ndë udhët që dotë shkoni, atëhere dotë sbritni qimet' e mia të-sbardhura me hidhërim ndë varrt.

Krye 43.

- 1 Edhe zia po rëndonej mbi dhet. 2) Edhe si mbaruanë së ngrëni drithëtë, të-cilëtë kishinë prurë nga Egjypta, i ati u tha atyre,
- 3 Shkoni përsëri, e na blini pak drithë. Edhe

Juda i tha ati, dyke thënë, Ay njeriu na ndë-
 nji fort kundrë, edhe tha, S' më kini për të
 parë sytë, ndë mos qoftë bashkë me ju vë-
 4 llaj juaj. Ndë dërgofsh vëllanë t' ënë bashkë
 me ne, dotë sbresëmë, e dotë të blemë dri-
 5 thë; Po ndë mos e dërgofsh, nukë dotë sbre-
 sëmë; sepse njeriu na tha, S' më kini për të
 parë sytë, ndë mos qoftë bashkë me ju vë-
 6 llaj juaj. Edhe Israili tha, Përse m'a bëtë këtë
 të-keqe, e i dëftyetë njeriut se kini edhe një
 7 tjetërë vëlla? Edhe ata thanë, Njeriu na py-
 eti thellë për ne e për far'e fisnë t' ënë,
 dyke thënë, A rron më ati juaj? a kini *tja-
 tërë* vëlla? Edhe neve i upërgjeqmë ati pas
 këtyre fjalëve; si muntnimë neve të dinimë
 8 se dotë thoshte, Birni vëllanë t' uaj? Edhe
 Juda i tha Israilit, atit të ti, Dërgo djalthi-
 në bashkë me mua, edhe letë ngrihemi e të
 vemi, që të rrojmë, e të mos vdesëmë, edhe
 9 neve, edhe ti, edhe djemtë t' anë. Unë të zo-
 tonem për atë; nga dora ime dot'a kërkonjç;
 ndë mos t'a prufsha ty atë, edhe t'a vë atë
 përpara teje, atëhere letë jem fajtuar te ti
 10 për jetë; Sepse po të mos kishimë mënuarë
kaqë, pa fjalë tashi dotë ishimë kthyerë të-
 11 dytënë herë. Edhe i ati i atyre Israil u tha
 atyre, Ndë është kështu, bëni këtë; merrni
 ndër thasët t' uaj nga më të-sgjedhuratë pe-
 më të dheut, edhe shpir-j'a-ni dhuratë ati
 njeriu, pak ballsam, e pak mjaltë, erëra të-

12 mira e myrrë, arra e bajame; Merrni edhe
 ergjënt të-dymëzuarë ndër duart t' uaj; edhe
 ergjëndinë që ishte kthyerë ndë grykët të
 thasëvet t' uaj bir-j'a-ni prapë; mundetë të
 13 jetë bërë me të-lajthiturë; Merrni edhe vëllanë
 14 t' uaj, edhe ngrihi, e kthehi te njeriu. Edhe
 Perëndia Fuqimadhi u dhëntë hir juve për-
 para njeriut, që të dërgonjë me ju *atë* tjatë-
 rinë vëllanë t' uaj, edhe Beniamininë; edhe
 unë ndë qoftë se mbetem pa djem, letë mbe-
 tem.
 15 Edhe njerëzitë si muarrë këto dhurata,
 muarrë edhe ergjënt të-dymësuarë ndë duart
 të tyre, edhe Beniamininë; pastaj ungritnë,
 e sbritnë ndë Egjyptë, edhe qëndruanë për-
 16 para Josifit. Edhe kur pa Josifi Beniamininë
 bashkë me ata, i tha kujdestarit të shtëpis'
 së ti, Shpjerë *këta* njerës ndë shtëpit, edhe
 ther *një berr*, e bëj gati; sepse njerëzitë dotë
 17 hanë drekënë bashkë me mua. Edhe njeriu
 bëri sikundrë urdhëroj Josifi; edhe njeriu
 18 shpuri njerëzitë ndë shtëpit të Josifit. Edhe
 njerëzit' ufrikësuanë, sepse i shpunë ndë shtë-
 pit të Josifit; edhe thanë, Për punë të ergjën-
 dit që ukthye ndë thasët t' anë herën' e-parë
 po na shpjenë brënda, që të gjenjë shkak
 kundrë nësh, e të hidhetë mbi ne, e të na
 marrë shërbëtorë *neve*, edhe gomarëtë t' anë.
 19 Edhe i uafëruanë kujdestarit të shtëpis' së
 Josifit, e i folnë ati ndë derët të shtëpisë.

20 Edhe i thanë, Të lutemi, zot; sbritmë herën'
 21 e-parë për të blerë drithë; Edhe kur erthmë
 ndë vëntt që ramë, hapmë thasëtë t'anë, edhe
 na ergjëndi i gjithë-sicilit tek ishte ndë gry-
 kët të thesit të ti, tërë ergjëndi ynë; andaj e
 22 prumë prapë ndë duart t'ona. Prumë edhe
 tjetërë ergjënt ndë duart t'ona, për të blerë
 drithë; nukë dimë se kush na e vuri ergënt-
 23 në t'ënë ndë thasët t'anë. Edhe ay tha, Paq-
 tim mbë ju; mos frikësohi; Perëndia juaj,
 edhe Perëndia i atërvet t'uaj, u dha juve the-
 sar ndë thasët t'uaj; ergjëndi juaj erdhi tek
 24 unë. Edhe u nxori atyre Simeoninë. Edhe
 njeriu i pruri njerëzitë ndë shtëpit të Josifit,
 edhe u dha ujë, e lanë këmbët'e tyre; edhe
 25 n dha të-ngrënë gomarëvet t'atyre. Edhe ata
 bënë gati dhuratat'e tyre, gjersa të vinte
 Josifi ndë mest të ditësë; sepse dëgjuanë, se
 atje kishinë për të ngrënë bukë.
 26 Edhe kur erdhi Josifi ndë shtëpit, i prunë
 ati ndë shtëpit dhuratatë, që i mbaninë ndë
 duart të tyre, edhe i unjnë kryetë gjer për-
 27 dhe. Edhe i pyeti ata për shëndetnë, edhe
 tha, A është shëndoshë ati juaj, ay plaku që
 28 më pattë thënë? A rron më? Edhe ata thanë,
 Shërbëtori yt është shëndoshë, edhe po rron.
 29 Edhe uunjnë e i ufalënë. Edhe ay kur shtyri
 syt'e tij, e pa Beniamininë, të vëllan'e ti, të
 birr'e mëmës' së tij, tha, Ky është vëllaj juaj
 m' i-vogëli, për të-cilinë më pattë folurë? Edhe

30 tha, Perëndia të përdëlleftë, djali im. Edhe
 Josifi çpejtoj të hiqej; sepse po i përzjene-
 shinë zorëtë për të vëllanë, edhe kërkonte
 vënt për të qarë; edhe si hyri ndë dhomët,
 31 atje qau. Pastaj lau faqen'e tij, edhe dolli;
 edhe dyke mbajturë vetëhen'e ti tha, Vini
 32 bukë. Edhe vunë veç për atë, edhe veç për
 ata, edhe veç për Egjyptianëtë që haninë bu-
 kë bashkë me atë; sepse Egjyptianëtë nukë
 muntninë të hanë bukë me Ebrenjtë; sepse
 33 këjo ishte një ndyrësi ndër Egjyptianët. Ndënj-
 në pra përpara ati, i-parëllinduri pas parëllin-
 djes' së tij, edhe më i-vogëli pas vogëlis' së
 ti; edhe njerëzitë po çuditëshinë ndë mest të
 34 tyre. Edhe ay mori gjellë që përpara vetëhes'
 së ti, e u'a dërgoj atyreve, po gjell' e Beniami-
 nit ishte pesë herë më e-tepërë se e gjithë-si-
 cilit nga ata. Edhe pinë, e ugëzuanë bashkë
 me atë.

Krye 44.

- 1 Edhe ay urdhëroj kujdestarin'e shtëpis'
 së ti, dyke thënë, Mbush thasët'e njerësvet
 me drithë sa munt të marrënë, edhe vërë er-
 gjëndin'e gjithë-sicilit ndë grykët të thesit.
- 2 Edhe vërë potirinë t'im, potirin'e-ergjëntë,
 ndë grykët të thesit të më të-vogëlit, si edhe
 ergjëndin'e drithit t'ati. Edhe ay bëri pas
 fjalësë që i tha Josifi.
- 3 Ndë mëngjest, posa usbardhëllye, dërgu-

- 4 anë njerëzitë, ata edhe gomarët' e atyre. Edhe passi duallnë jashtë qytetit, edhe nuk' ishinë larguarë shumë, Josifi i tha kujdestarit të ti, Ngreu, sulu pas njerësvet; edhe kur t' i arrinjç, thuaj-u atyre, Përse bëtë keq ndë vëntt
- 5 të së-mirësë? A nuk' është ky *potiri*, me të-cilinë pi im zot, edhe me të-cilinë dëften me të-vërtetë ato që dotë bënenë? keq e bëtë këtë punë që bëtë.
- 6 Edhe posa i arriti ata, u tha atyre këto
- 7 fjalë. Edhe ata i than' ati, Përse flet zoti ynë të-këtilla fjalë? Zoti mos e dhëntë që shërbëtorët' e tu të bënjënë një të-këtitillë punë.
- 8 Na ergjëndinë që gjetmë ndë grykët të thasëvet t' anë tek t'a prumë prapë ty nga dheu i Hanaanit, e qysh dotë vidhimë nga shtëpia e t' yt zot ergjënt a ar? Te cilido nga shërbëtorët' e tu që të gjendetë, letë vritetë, edhe neve dot' i bënemi shërbëtorë zotit t' ënë.
- 10 Edhe ay tha, Edhe tashi letë bënetë sikundrë thoni; ay, tek i-cili të gjendetë, dotë bënetë shërbëtori im, edhe ju dotë jeni të-pafajm.
- 11 Atëhere ata çpejtuanë, e çkarkuanë gjithë-sicili thesin' e ti mbë dhet, edhe hapi gjithë-sicili thesin' e ti. Edhe kërkoj, dyke zënë nga m' i-madhi, edhe dyke mbaruarë te m' i-vogëli; edhe potiri ugjënt ndë thest të Beniaminit.
- 13 Atëhere ata çarrë rrobat' e tyre, edhe ngarkuanë gjithë-sicili gomarin' e ti, e ukthyenë ndë qytett.

- 14 Edhe vate Juda edhe të vëllezërit' e ti ndë shtëpit të Josifit, i-cili edhe ishte atje; edhe ranë përpara ati mbi dhet.
- 15 Edhe Josifi u tha atyre, Ç' punë është këjo që bëtë? a nukë dini ju se unë jam një njeri që di me të-vërtetë seç bënetë?
- 16 Edhe Juda tha, Ç' t' i themi t' im zot? ç' t' i flasëmë? a qysh të lajmë vetëhenë t' ënë? Perëndia gjeti paudhërin' e shërbëtorëvet të tu; na tek jemi shërbëtorët' e t' im zot, edhe neve, edhe ay, ndë dorët të të-cilit ugjent potiri.
- 17 Edhe ay tha, Zoti mos e dhëntë të bënj këtë; ay njeri, ndë dorët të të-cilit ugjent potiri, *vetëmë* ay dotë më jetë shërbëtuar; po ju shkoni ndë paqtim për te ati juaj.
- 18 Atëhere Juda i uafërua ati, e tha, Të lutem, zoti im; shërbëtori yt letë flasë një fjalë ndë veshët të t' im zot, edhe letë mos ndizetë zëmërimi yt kundrë shërbëtorit t' ënt;
- 19 sepse ti je posi Faraoni. Im zot pyeti shërbëtorët' e ti, dyke thënë, A kini atë, a vëlla?
- 20 Edhe i thamë t' im zot, Kemi një atë plak, edhe një djalë të pleqëris' s' ati, të-vogëlë; edhe i vëllaj i ati vdiq; edhe vetëm' ay ka mbeturë nga e ëma, edhe i ati e do fort atë.
- 21 Edhe ti u the shërbëtorëvet të tu, Sill-e-ni
- 22 atë tek unë që t'a shoh me syt' e mi. Edhe neve i thamë zotit t' im, Djali s' munt të lërë t' anë; sepse, ndë e lëntë t' anë, ky dotë vde-

23 së. Edhe ti u the shërbëtorëvet të tu, Ndë
 mos arthtë bashkë me ju vëllaj juaj m' i-vo-
 24 gëli, nukë dotë më shihni sytë më. Edhe kur
 vamë te shërbëtori yt im atë, j'a thamë fja-
 25 lët' e t' im zot. Edhe ati ynë tha, Shkoni për-
 26 sëri, e na blini pak drithë. Edhe neve thamë,
 Nukë munt të sbresëmë; po ndë qoftë bash-
 kë me ne vëllaj ynë më i-vogëli, atëhere dotë
 sbresëmë; sepse s' munt t' i shohëmë syt' e
 ati njeriu, ndë mos qoftë bashkë me ne vë-
 27 llaj ynë më i-vogëli. Edhe shërbëtori yt im
 atë na tha, Ju e dini se ime shoqe më polli
 28 dy *djem*; Edhe njëri dolli që përënë meje,
 edhe thashë, Me të-vërtetë prej bishe është
 copëtuarë; edhe që atëhere atë nuk' e kam
 29 parë; Edhe ndë marrçi edhe këtë prej meje,
 e t' i gjanjë ndonjë e-keqe, dotë më sbritni
 qimet' e-sbardhura me hidhërim ndë varrt.
 30 Tashi pra kur të vete te shërbëtori yt im
 atë, edhe djali të mos jetë bashkë me ne,
 (sepse shpirti i atij është lidhurë me shpir-
 31 tin' e djalit,) Posa të shohë se djali nuk'
 është, dotë vdesë; edhe shërbëtorët' e tu dotë
 sbresënë qimet' e-sbardhura të shërbëtorit
 32 t' ënt atit t' ënë me hidhërim ndë varrt. Se-
 pse shërbëtori yt i uzotua t' im et për dja-
 lënë, dyke thënë, Ndë mos t'a prufsha atë
 ty, atëhere dotë jem fajtuar tek im atë për
 33 jetë. Tashi pra, të lutem, letë mbetetë shër-
 bëtori yt ndë vëntt të djalit shërbëtuar të

im zot; edhe djali letë shkonjë bashkë me
 34 të vëllezërit' e ti. Sepse qysh te vete tek im
 atë, ndë mos qoftë djali bashkë me mua?
 Ah! mos e pafsha atë të-keqe që ka për të
 gjeturë t' im atë!

Krye 45.

- 1 Atëhere Josifi nukë mundi të mbante ve-
 tëhen' e ti përpara gjith' atyreve që rrininë
 përpara ati; edhe thirri, Nxirni të-gjithë që
 përpara meje. Edhe nukë mbeti asndonjë
 bashkë me atë, kur po bënte Josifi vetëhen'
 2 e ti të-njohurë te vëllezërit' e tij. Edhe qau
 me zë të-fortë; edhe dëgjuanë Egjyptianëtë;
 3 dëgjoj edhe shtëpia e Faraonit. Edhe Josifi
 u tha të vëllezërvet, Unë jam Josifi; a rron
 më im atë?
 Edhe të vëllezërit' e ati s' muntninë t' i
 përgjigjeshinë; sepse utrumbulluanë përpa-
 ra ati.
- 4 Edhe Josifi u tha të vëllezërvet, Afërohi
 tek unë, u lutem. Edhe ata uafëruanë. Edhe
 tha, Unë jam Josifi, vëllaj juaj, që e shittë
 5 ndë Egjyptë. Tashi pra mos hidhërohi, as
 mos zëmërohi kundrë vetëhesë s' uaj, se më
 shittë këtu; sepse Perëndia më dërgoj për-
 6 para jush, për të ruajturë jetënë t' uaj. Sepse
 ky është i-dyti vit i zisë mbi dhet, edhe janë
 edhe pesë vjet *të-tjerë*, ndë të-cilët nukë dotë
 7 ketë as të-lëruarë, as të-korrë. Edhe Perën-

- dia më dërgoj përpara jush, që t' u ruanj juve farë mbi dhet, edhe t' u ruanj juve je-
 8 tënë me anë një shpëtimi të-math. Kështu pra nukë ishitë ju që më dërguatë këtu, po Perëndia; edhe më bëri atë te Faraoni, edhe zot të gjithë shtëpis' s' atij, edhe të-parë mbi
 9 gjithë dhen' e Egjyptësë. Çpejtoni, e hipni tek im atë, e i thoni, Kështu thotë yt bir Josif; Perëndia më bëri zot të gjithë Egjyptësë;
 10 sbrit tek unë, *edhe* mos mëno; Edhe dotë rrish ndë dhet të Goshenit, edhe dotë jesh afërë meje, ti, edhe bijt' e tu, edhe bijt' e bijvet të tu, edhe dhënt' e tua, edhe lopët' e tua, edhe gjithë
 11 thë ç' ke; Edhe dotë të ushqenj atje, (sepse dotë jenë edhe pesë vjet zie,) që të mos vinjë ndë vobëzi, ti, edhe shtëpia jote, edhe gjithë
 12 sa ke. Edhe na tek shohënë sytë t' uaj, edhe syt' e t' im vëllaj Beniamin, se goja ime po
 13 u flet juve. Epni pra zë t' im et për gjithë lavdinë t' ime ndë Egjyptë, edhe për gjithë sa patë; edhe çpejtoni, e sbritni t' im atë këtu.
 14 Pastaj ra mbi qafët të vëllajt të ti Beniamin, e qau; edhe Beniamini qau mbi qafët
 15 t' ati. Edhe puthi gjithë të vëllezërit' e ti, e qau mbi ata; edhe pastaj të vëllezëritë folnë bashkë me atë.
 16 Edhe udëgjua zëri ndë shtëpit të Faraonit, e thanë, se erdhë të vëllezërit' e Josifit; edhe Faraoni ugëzua, *si* edhe shërbëtorët' e

- 17 ati. Edhe Faraoni i tha Josifit, Thuaj-u t' ët vëllezërve, Këtë bëni; ngarkoni kafshëtë t' uaj, edhe shkoni, e ecëni ndë dhet të Hanaanit.
 18 Edhe si të merrni atinë t' uaj, edhe fëmijëtë t' uaj, eni tek unë; edhe dot' u ap *gjithë* lëmirat' e Egjyptësë, edhe dotë hani të-majmit'
 19 e dheut. Tashi je urdhëruarë *t' u thuash atyre*, Bëni këtë, merrni me vetëhenë t' uaj qerre nga dheu i Egjyptësë për të-vegjëlitë t' uaj, e për gratë t' uaj; edhe merrni atinë t' uaj, e ejani.
 20 Edhe të mos u vinjë keq për plaçkatë t' uaj; sepse të-mirat' e gjithë dheut të Egjyptësë dotë jenë t' uajatë.
 21 Edhe të bijt' e Israilit bënë kështu; edhe Josifi u dha atyre qerre, pas urdhërit të Faraonit; u dha atyre edhe të-ngrëna për u-
 22 dhësë. Edhe gjithë-sicilit nga ata i dha rroba për të ndërruarë; po Beniaminit i dha treqint *copë* ergjëndi, edhe pesë palë rroba.
 23 Edhe t' et i dërqoj këto: dhjetë gomarë ngarkuarë me të-mirat' e Egjyptësë, edhe dhjetë gomarë ngarkuarë me grurë e me bukë, edhe
 24 të-ngrëna t' et për udhësë. Kështu dërgoj të vëllezërit' e tij, edhe *ata* shkuanë; edhe u tha atyre, Mos zihni udhësë.
 25 Edhe ungritnë nga Egjypta, e erthnë ndë
 26 dhet të Hanaanit te Jakobi, i at' i tyre. Edhe i dhanë zë ati, dyke thënë, Josifi është edhe gjall, edhe është' i-parë mbi gjithë dhen' e Egjyptësë. Edhe i uporrit zëmëra ati, sepse

- 27 nuk' i besonte ata. Edhe ata i than' ati gjithë fjalët' e Josifit që u pat thënë atyreve; edhe passi pa qerretë që kishte dërguarë Josifi për të ngritur' atë, i erdhi fryma prapë Jakobit,
- 28 t' et t' atyreve. Edhe Israili tha, Mjaft; Josifi, im bir, qënka edhe gjall; dotë vete e dot' e shoh atë, përpara se të vdes.

Krye 46.

- 1 Edhe Israili ungrit bashkë me gjithë ç' kishte, edhe erdhi ndë Beer-sheba, edhe i pruri kurbanë Perëndis' së t' et Isaak.
- 2 Edhe Perëndia i tha Israilit natënë nd' ëndërrë, edhe tha, Jakob, Jakob. Edhe ay tha, Na
- 3 këtu jam. Edhe *Perëndia* tha, Unë jam Perëndia, Perëndia i t' yt et; mos ufrikëso të sbresç ndë Egjyptë; *sepse* të kam për të bërë ty atje komp të-math; Unë dotë sbres bashkë me ty ndë Egjyptë, edhe unë me të-vërtetë dotë të ngjit prapë; edhe Josifi dotë vërë dorën' e ti mbi syt të tu.
- 5 Edhe Jakobi ungrit nga Beer-shebaja; edhe të bijt' e Israilit vunë Jakobinë, t' an' e tyre, edhe djemt' e tyre, edhe grat' e tyre, mbi qerret që kishte dërguarë Faraoni për të ngritur' atë. Edhe muarrë bagëtit' e tyre, edhe gjën' e tyre që kishinë fituarë ndë dhet të Hanaanit, edhe erdhë ndë Egjyptë, Jakobi
- 7 edhe gjithë far' e ati bashkë me atë; Bijt' e ti, e bijt' e bijvet të ti bashkë me atë, bijat'

- e tia, edhe bijat' e të bijvet e gjithë farën' e tij e pru me vetëhe ndë Egjyptë.
- 8 Edhe këta janë emërat' e të bijvet të Israilit që hynë nd' Egjyptë, Jakobi edhe të bijt' e ati; Rubini, i-parëlinduri i Jakobit;
- 9 Edhe të bijt' e Rubinit, Hanohu, e Palluj, e
- 10 Hezroni, e Harmiu. Edhe të bijt' e Simeonit, Jemueli, e Jamini, e Ohadi, e Jaqini, e Zohari,
- 11 e Shauli, i bir' i një gruaje Hanaanite. Edhe të bijt' e Leviut, Gjershoni, e Kohathi, e Merariu. Edhe të bijt' e Judësë, Eri, e Onani, e Shellahu, e Farezi, e Zarahu. Po Eri e Onani vdiqnë ndë dhet të Hanaanit. Edhe të bijt'
- 13 e Farezit ishinë Hezroni e Hamulli. Edhe të bijt' e Issaharit, Tollaj, e Fabahu, e Jobi, e
- 14 Shimroni. Edhe të bijt' e Zabullonit, Seredi, e Elloni, e Jahleeli. Këta janë të bijt' e Leahësë, të-cilëtë j'a polli Jakobit ndë Paddan-aram, bashkë me të bijën' e ati Dinahë; gjithë shpirtët' e bijvet t' atij edhe të bijavet t' atij *ishinë* tri-dhjet' e tre.
- 16 Edhe të bijt' e Gadit, Zifioni, e Haggi, Shuniu, e Ezboni, Eriu, e Arodiu, e Areliu.
- 17 Edhe të bijt' e Asherit, Imnahu, e Ishvahu, e Ishviu, e Beriahu, e Saraha, e motëra e atyre; edhe të bijt' e Beriahut, Heberi, e Mallqieli.
- 18 Këta janë të bijt' e Zilpahësë, të-cilënë j'a dha Llabani Leahësë, së bijësë, edhe këta j'a polli Jakobit, gjashtë-mbë-dhjetë shpirt.
- 19 Të bijt' e Rahilësë, së shoqes' së Jakobit,

- 20 Josifi e Beniamini. Edhe Josifit ndë dhet të Egjyptësë i patnë lindurë Manassehu e Efraimi, të-cilëtë j'a polli Asenatha, e bija e Poti-
 21 ferajt, priftit të Onit. Edhe të bijt' e Beniaminit, Bellaj, e Beheri, e Ashbeli, e Gjeraj, e Naamani, e Ehiu, e Roshi, e Muppimi, e Hup-
 22 pimi, e Ardi. Këta janë bijt' e Rahilësë, të-cilëtë j'a polli Jakobit; të gjithë katrë-mbëdhjetë shpirt.
- 23 Edhe të bijt' e Danit, Hushimi. 24) Edhe të bijt' e Nefthaliut, Jahzeeli, e Guniu, e Jezeri,
 25 e Shillemi. Këta janë të bijt' e Bilhahësë, të cilënë j'a pat dhënë Llabani së bijësë Rahilë; edhe këta ajo j'a polli Jakobit; të-gjithë *ishinë* shtatë shpirt.
- 26 Gjithë shpirtetë që hynë ndë Egjyptë bashkë me Jakobinë, të-cilëtë duallë nga mezi i Jakobit, përveç gravet të bijvet të Jakobit, të-gjith' *ishinë* gjashtë-dhjet' e gjashtë shpirt.
- 27 Edhe të bijt' e Josifit që i kishinë lindurë ndë Egjyptë, *ishinë* dy shpirt. Gjithë shpirtet' e shtëpis' së Jakobit, që hynë ndë Egjyptë, *ishinë* shtatë-dhjetë.
- 28 Edhe *Jakobi* dërgoj Judënë përpara vetëhes' së ti te Josifi, që të rrëfente përpara ati udhënë për ndë Goshen. Edhe erthnë ndë
 29 dhet të Goshenit. Edhe Josifi bëri gati qerren' e ti, edhe hipi për ndë Goshen, që të dilte përpara atit të ti Israil; edhe kur erdhi përpara ati, uhoth mbi qafët. t' ati, edhe qau

- 30 shumë kohë mbi qafët t' ati. Edhe Israili i tha Josifit, Letë vdes tashi që pashë syt' e tu, sepse ti qënke edhe gjall.
- 31 Edhe Josifi u tha të vëllezërvet, edhe shtëpis' së t' et, Unë dotë ngjitem, e dot' i ap zë Faraonit, e t' i them, Vëllezërit' e mi, edhe shtëpia e t' im et, që *ishinë* ndë dhet të Hanaanit, erthnë tek unë; Edhe njerëzitë janë barinj, sepse janë njerës që mbajnënë bagëti; edhe kanë prurë dhënt' e tyre, e lopët' e tyre,
 33 e gjithë ç' kanë. Edhe kur t' u thërresë juve
 34 Faraoni, edhe t' u thotë, Cila është puna juaj? t' i thoni, Shërbëtorët' e tu jemi njerës që kemi mbajturë bagëti që ndë djelërit t' ënë e gjer tashi, edhe neve; edhe atëritë t' anë; që kështu të rrini ndë dhet të Goshenit; sepse çdo bari Egjypianët' e kanë për ndyrësi.

Krye 47.

- 1 Edhe Josifi erdhi, e i dha zë Faraonit, edhe i tha, Im atë, edhe t' im vëllezër, edhe dhënt' e atyre, edhe lopët' e atyre, edhe gjithë ç' kanë, erthnë nga dheu i Hanaanit, edhe na
 2 tek janë ndë dhet të Goshenit. Edhe mori prej vëllezërvet të ti shtatë burra, e i nxori
 3 përpara Faraonit. Edhe Faraoni u tha të vëllezërvet t' ati, Cila është puna juaj?
 Edhe ata i thanë Faraonit, Barinj janë shërbëtorët' e tu, edhe neve edhe atëritë t' anë.
 4 Pastaj i thanë Faraonit, Erthmë që të rrimë

ca kohë ndë këtë dhe; sepse s' ka kullotë për tufët' e shërbëtorëvet të tu; sepse zia urëndua ndë dhet të Hanaanit; tashi pra të lutemi, letë rrimë shërbëtorët' e tu ndë dhet të Goshenit.

5 Edhe Faraoni i foli Josifit, e i tha, Yt atë
6 edhe t' ët vëllezër erthnë te ti; Dheu i Egjyptësë është përpara teje; ndë më të-mirët dhe vërë të rinë yt atë edhe t' ët vëllezër; letë rrinë ndë dhet të Goshenit; edhe ndë di se gjëndenë ndër ata burra të-zotër, vër'-i ata kujdestarë mbi bagëtitt të mia.

7 Edhe Josifi futi Jakobinë, atin' e ti, edhe e nxori përpara Faraonit; edhe Jakobi bekoj
8 Faraoninë. Edhe Faraoni i tha Jakobit, Si sa të jenë ditt' e vjetvet të jetësë s' ate?

9 Edhe Jakobi i tha Faraonit, Ditt' e vjetvet të të-rrrojturit t' im andej e këtej janë një qint e tri-dhjetë vjet; të-paka e të-këqia kanë qënë ditt' e vjetvet të jetësë s' ime, edhe nuk' u'a kanë arriturë ditvet të vjetvet të jetës' së atërvet të mi ndë ditt të të-rrrojturit
10 t' atyre andej e këtej. Edhe Jakobi e bekoj Faraoninë, edhe dolli që përpara Faraonit.

11 Edhe Josifi vëndosi t' anë edhe të vëllezëritë, edhe u dha atyre vënt ndë dhet të Egjyptësë, ndë më të-mirët dhe, ndë dhet të
12 Ramesësë, sikundrë urdhëroj Faraoni. Edhe Josifi ushqente me bukë t' anë, edhe të vëllezëritë, edhe gjithë s pin' e t' et, sipas fëmijëvet t' atyre.

13 Edhe nukë kishte bukë mbë gjithë dhe-në; sepse zia ishte fort e-madhe, kaqë sa dheu i Egjyptësë edhe dheu i Hanaanit u-

14 shuanë nga zia. Edhe Josifi mbloodhi gjithë ergjëndinë që gjëndej ndë dhet të Egjyptësë, e ndë dhet të Hanaanit, për drithëtë që bli-ninë; edhe Josifi pruri ergjëndinë ndë shtë-

15 pit të Faraonit. Edhe kur umbarua ergjëndi nga dheu i Egjyptësë, e nga dheu i Hanaanit, erthnë gjithë Egjyptianëtë te Josifi, e i thanë, Ep-na bukë; sepse përse të vdesëmë përpara teje? sepse *na* umbarua ergjëndi.

16 Edhe Josifi tha, Bini bagëtitt t' uaj, edhe dot' u ap *bukë* ndë vëntt të bagëtivet, ndë umba-

17 rua ergjëndi. Edhe *ata* prunë bagëtitt' e tyre te Josifi; edhe Josifi u dha atyre bukë ndë vëntt të kuajvet, e ndë vëntt të dhënvet, e ndë vëntt të qevet, e ndë vëntt të gomarëvet; edhe i ushquu ata me bukë atë vit për gjithë bagëtitt' e atyre.

18 Edhe si umbarua ay vit, erthnë tek ay të-dytinë vit, e i than' ati, Nukë dot'a fshe-hëmë prej zotit t' ënë se na umbarua gjithë ergjëndi; edhe bagëtittë ubënë te zotit t' ënë; asgjë s' na ka mbeturë përpara zotit t' ënë,
19 veç trupatë t' anë edhe dheu ynë. Përse pra të hymbasëmë përpara syvet të tu, edhe neve edhe dheu ynë? Bli-na neve edhe dhenë t' ënë për bukënë *që dotë na apç*, edhe dotë jemi, neve edhe dheu ynë, shërbëtorë te Faraoni;

- edhe ep-na farë, që të rrojmë, e të mos vde-sëmë, edhe dheu të mos shkretonetë.
- 20 Kështu Josifi bleu gjithë dhen' e Egjyptësë për Faraoninë; sepse Egjyptianëtë shitnë gjithë-sicili arën' e ti, sepse zia urëndua tepërë mbi ata. Kështu dheu ubë i Faraonit.
- 21 Edhe sa për gjindjenë, i shpuri ndë qytetet, që nga njëra anë e sinorëvet të Egjyptësë e
- 22 gjer ndë tjatërët anë t' asaj. Vetëmë dhen' e priftërvet nuk' e bleu; sepse priftëritë kishinë pjesën' e tyre nga Faraoni, edhe haninë pjesën' e tyre që u epte Faraoni. Përandaj nuk' e shitnë dhen' e tyre.
- 23 Atëhere Josifi i tha gjindjesë, Na tek bleva juve edhe dhenë t' uaj sot për Faraoninë; na këtu tek ka farë për juve, edhe mbillni dhenë.
- 24 Edhe ndë kohët të të-mbledhurit të *dhedhënë-jevet*, një të-pesëtë dot' j'a epni Faraonit, edhe katrë pjesë dotë jenë t' uajatë, për farë të aravet, e për ushqimnë t' uaj, e për ata që janë ndë shtëpit t' uaj, edhe për ushqim të djemvet t' uaj.
- 25 Edhe ata thanë, Ti na shpëtove jetënë; letë gjejmë hir përpara zotit t' ënë, edhe dotë jemi shërbëtorë të Faraonit.
- 26 Edhe Josifi e bëri këtë për nom që mbeti ndë dhet të Egjyptësë, gjer mbë sot, t' i epetë një e-pesëtë Faraonit; vetëmë dheu i priftërvet nuk' ubë i Faraonit.
- 27 Edhe Israili ndënji ndë dhet të Egjyptësë, ndë dhet të Goshenit; edhe fituanë gjë nd' atë, edhe ushtuanë e ushumuanë fort.

- 28 Edhe Jakobi rrojti edhe shtatë-mbë-dhjetë vjet ndë dhet të Egjyptësë; kështu ditt' e Jakobit, vjett' e jetësë s' ati, ubënë një qint e dyzet e shtatë vjet.
- 29 Edhe uafërua koha që të vdiste Israili; edhe thirri të birr' e ti Josif, e i tha, Ndë kam gjeturë hir tashi përpara teje, të lutem, vërë dorënë t' ende ndënë kofshët t' ime, edhe bëj mbë mua përdëllim e të-vërtetë; mos më
- 30 varro, të lutem, ndë Egjyptë; Po kur të fle me atërit' e mi, të më nxjerç nga Egjypta, edhe të më varrosh ndë varrt t' atyreve. Edhe
- 31 ay tha, Unë dotë bënj sikundrë më the. Edhe ay tha, Bë-më be; edhe ay i bëri be. Edhe Israili ufal mbi ndënëkresët të shtratit.

Krye 48.

- 1 Edhe pas këtyre punëve, i thanë Josifit, Na yt atë tek është i-sëmurë. Edhe mori me vetëhe të dy të bijt' e ti, Manassehunë edhe
- 2 Efraiminë. Edhe i dhanë zë Jakobit, e i thanë, Na yt bir Josifi tek po vjen te ti; edhe Israili mori fuqi e ndënji mbi shtratt.
- 3 Edhe Jakobi i tha Josifit, Perëndia Fuqimadhi m' uduk ndë Lluz ndë dhet të Hana-
- 4 anit, edhe më bekoj, Edhe më tha, Na unë tek dotë të shtonj, e dotë të të shumonj ty, edhe dotë bënj prej teje shumicë kombesh; edhe dot' j'a ap këtë dhe farësë s' ate pas
- 5 teje për kamje të saj të-përjetëshme. Tashi

pra të dy bijt' e tu, të-cilëtë të kanë lindurë ndë dhet të Egjyptësë, para se të vinj unë të ti ndë Egjyptë, janë të-mitë; Efraimi edhe Manassehu dotë jenë të-mitë posi Rubini edhe 6 Simeoni. Po djemt' e tu që të lintnjënë pas këtyre dotë jenë të-tutë; dotë quhenë ndë trashëgimt të tyre pas emërit të vëllezërvet të tyre. 7 Edhe unë kur po vinjam nga Paddani, më vdiq Rahila udhësë ndë dhet të Hanaanit, kur na mbetej edhe pak udhë që të arrinimë ndë Efratha; edhe e kalla ndë varr atje ndë udhët për ndë Efratha (e-cila është Bithlehema). 8 Edhe Israili, kur pa të bijt' e Josifit, tha, 9 Cilëtë janë këta? Edhe Josifi i tha t' et, Këta janë bijt' e mi që më dha Perëndia këtu. Edhe ay tha, Të lutem, bjer'-i ata tek unë, që t' i 10 bekonj. Edhe syt' e Israilit ishinë errësuarë nga pleqëria kaqë, sa nukë muntte të shihte. Edhe i pruri ata për an' ati; edhe ay i puthi ata, edhe 11 i pushtoj ata. Edhe Israili i tha Josifit, Nukë shprenjam të shihnjam syt' e tu; edhe na Perëndia tek më bëri të shoh edhe farënë t' ende. 12 Edhe Josifi i hoqi ata nga gjunjët' e ati, edhe 13 uunj me faqen' e ti gjer përdhe. Edhe Josifi mori ata të dy, Efraimnë mbë të-djathtë të ti, e mbë të-mëngjërë të Israilit, edhe Manassehunë mbë të-mëngjërë të ti, e mbë të-djathtë të Israilit, edhe j'a afëroj ati. Edhe 14 Israili ndejti të-djathtën' e ti, edhe e vuri mbi kryet të Efraimit, i-cili ishte më i-vogëli,

edhe të-mëngjërën' e ti mbi kryet të Manassehut, dyke çkëmbyerë me qëllim duart' e tia; sepse Manassehu ishte i-parëlinduri. 15 Edhe bekoj Josifnë, e tha, Perëndia, përpara të-cilit ecnë atërit' e mi Abraam edhe Isaak, Perëndia i-cili më kulloti gjithë jetënë 16 t'ime gjer mbë këtë ditë, Ëngjëlli që më shpëtoj nga gjithë të-ligatë, i bekoftë këta djem; edhe uquajtë emëri im mbi ata, edhe emëri i atërvet të mi Abraam edhe Isaak, edhe ushumofshinë mbë shumicë të-madhe mbi dhet. 17 Edhe kur pa Josifi se i ati vuri dorën' e ti të-djathtë mbi kryet të Efraimit, i erdhi rëndë; edhe zuri dorën' e t' et, që t' j'a binte nga kryet' e Efraimit mbi kryet të Manassehut. Edhe Josifi i tha t' et, Mos kështu, ati im, sepse ky është i-parëlinduri; vërë të-djathtënë t' ende mbi kryet t' ati. Po i ati nukë deshi, edhe tha, E di, biri im, e di; edhe ky dotë bënetë një gjindje; edhe ky dotë bënetë i-math; po i vëllaj i ati më i-vogëli dotë jetë më i-math se ay, edhe fara e ati dotë bënetë shumicë kombesh. 20 Edhe atë ditë i bekoj, e tha, Mbë ty dotë uronjë Israili, dyke thënë, Perëndia të bekoftë posi Etraimnë e posi Manassehunë! Edhe vuri Efraimnë përpara Manassehut. 21 Edhe Israili i tha Josifit, Na unë tek po vdes; po Perëndia dotë jetë bashkë me ju, edhe dot' u bjerë juve përsësi ndë dhet të

22 atërvet t' uaj. Edhe unë po të ap ty një pjesë më tepërë se vëllezërvet të tu, atë që mora nga dora e Amoritëvet me kordhënë t' ime e me hargunë t' im.

Krye 49.

- 1 Edhe Jakobi thirri të bijt' e ti, e tha, Mblidhuni që t'u rrëfenj juve, ç' ka për të gjarë ndër ju ndë ditt të-pastajme.
- 2 Mblidhuni, e dëgjoni, o të bij' e Jakobit, Edhe mbani vesh Israilit, atit t' uaj.
- 3 Rubin, ti je i-parëlinduri im, fuqia ime, edhe të-nisurit' e fuqivet të mia, I-çquarë nga vëjejtja, edhe i-çquarë nga fuqia.
- 4 I-paqëndruarshim posi ujëtë; nukë dotë kesh parësinë;
Sepse hipe mbi shtratt te t' yt et;
Atëhere e ndyre atë; mbi shtratt t'im hipi.
- 5 Simeoni edhe Leviu janë vëllezër;
Orëndi shtrëmbërie janë kordhët' e atyre.
- 6 O shpirti im, ndë këshillët t' atyre mos hyrë;
Me përmbledhjen' e atyre, o nderi im, mos ubashko;
Sepse ndë zëmërimt të tyre vranë njerës,
Edhe ndë zëmëratët të tyre prenë dej qesh.
- 7 I-mallëkuarë qoftë zëmërim' i atyre, sepse ishte i-egërë;
Edhe mëria e atyreve, sepse ishte e-ashpërë.
Dot' i përndanj ata te Jakobi,

- Edhe dot' i çpërndanj te Israili.
- 8 Judë, vëllezërit' e tu dotë të lavduronjënë;
Dora jote dotë jetë mbi sverk t' armiqvet të tu;
Të bijt' e t'yt et dotë unjënë kryetë për-Juda është këlush leoni; [para teje.
Biri im, ungjite prej gjahut.
Ra e flejti posi leon, edhe posi leonëshë;
kush dot'a sgjonjë atë?
- 10 Shkopi nukë dotë hiqetë prej Judësë,
As nomdhënës nga mezi i këmbëvet t' ati,
Gjersa të vinjë Shillohu;
Edhe ati dot' i bindenë gjindjetë.
- 11 Lith pulishtin' e ti ndë vreshtët,
Edhe ndë vreshtë të-sgjedhurë të-vogëlin'
Lau rrobat' e ti me verë; [e gomares' së ti;
Edhe petkun' e ti me gjak rrushi.
- 12 Syt' e ati dotë jenë të-kuq nga vera,
Edhe dhëmbët' e ati të-bardhë nga qumë-
- 13 Zabulloni dotë rrijë ndë liman deti, [shti.
Edhe dotë jetë liman anijash;
Edhe sinori i ati gjer ndë Sidhonë.
- 14 Issahari është gomar i-fortë,
Që dergjetë ndë mest të mandravet;
Edhe kur pa një vënt të prëjturi se ish-
Edhe dheu se ishte i-pëlqyerë, [te i-mirë,
Unji supn' e ti ndënë barrë
Edhe ubë shërbëtuat ndënë pagesë.
- 16 Dani dotë gjykonjë gjindjen' e ti,
Posi një nga farat' e Israilit.

- 17 Dani dotë jetë gjarpër ndë udhët,
Nepërkë ndë rrugët,
Që kafshon thundrat' e kalit,
Edhe kalorësi i ati bje praptezë.
- 18 Prita shpëtimnë t' ënt, o Zot.
- 19 Gadinë dot'a rjepënë kursarë,
Po edhe ay më ndë funtt dotë rjepë.
- 20 Buka a Asherit dotë jet' e-majme,
Edhe ay dotë apë shëfrime mbreti.
- 21 Nefthaliu është posi drer i-lëshuarë;
Ep fjalë të-pëlqyera.
- 22 Josifi është degë pemësjellëse,
Degë pemësjellëse përënë burimit;
Bisqet' i shtrihenë mbi murt.
- 23 Harkëtorëtë e hidhëruanë keq,
Edhe shigjetuanë mbi atë, edhe e ndoqnë;
- 24 Po hargu i ati mbeti i-fortë,
Edhe krahët' e duarvet t' ati uforcuanë,
Me anë të duarvet të të-Fortit të Jakobit,
25 (Prej andej është bariu, shkëmbi i Israilit,)
Me anë të Perëndis' së t' yt et, i-cili dotë
të ndihnjë,
Edhe me anë të Fuqimadhit, i-cili dotë
Me bekime të qiellit që lart, [të bekonjë,
Me bekime të avysësë që poshtë,
Me bekime të sisëvet e të shtratit.
- 26 Bekimet' e t' yt et duallë më të-fortë se
bekimet' e prindërvet të mi,
Gjer mbë majat më të-larta të malevet të-
Dotë jenë mbi kryet të Josifit, [përjetëshm;

- Edhe mbi kurorët të krejt t' ati që është i-
parë ndër mest të vëllezërvet të ti.
- 27 Beniamini është ujk rrëmbenjës;
Ndë mëngjest dotë hajë gjah,
Edhe mbrëmanet dotë ndanjë plaçka.
- 28 Këta të-gjithë janë të dy-mbë-dhjetë farat'
e Israilit, edhe këjo është ajo që u foli atyre
i ati, edhe i bekoj ata; gjithë-sicilinë pas be-
kimit t' ati i bekoj ata.
- 29 Edhe i porositi ata, e u tha, Unë po mbli-
dhem te gjindja ime; kall-më-ni ndë varr
bashkë me atërit' e mi, ndë shpellët që është
- 30 nd' arët të Efron Hittitit; Ndë shpellët që është
nd' arët të Mahpellahut, që është kundruell
Mamrisë, ndë dhet të Hanaanit, të-cilën' e
bleu Abraami bashkë me arënë nga Efron
- 31 Hittiti për vënt varri; Atje kallnë ndë varr
Abraaminë edhe Sarrënë, gruan' e ati; atje
kallnë ndë varr Isaakunë edhe Rebekkënë,
gruan' e ati; atje edhe unë kalla ndë varr
- 32 Leahënë. Ara edhe shpella që është nd' atë
uble nga të bijt' e Hethit.
- 33 Edhe Jakobi passi mbaroj së porosituri
të bijt' e ti, hoqi këmbët' e tia ndë shtratt,
edhe dha frymënë, edhe umbloth ndë gjin-
djet të ti.

Krye 50.

- 1 Edhe Josifi ra mbi faqet të t' et, e qau
2 mbi atë, edhe e puthi. Edhe Josifi urdhëroj

- shërbëtorët' e ti, mjekësitë, të ballsamosnjënë atin' e ati; edhe mjekësitë e ballsamosnë Is-
 3 railinë. Edhe umbushnë dyzet dit për atë; sepse kështu mbushenë ditt' e të-ballsamosurit; edhe Egjyptianëtë mbajtnë zi shtatë-dhjetë dit për atë.
- 4 Edhe passi shkuanë ditt' e zisë për atë, Josifi foli ndë shtëpit të Faraonit, dyke thënë, Tashi ndë kam gjeturë hir përpara jush flitni, u lutem, ndë veshët të Faraonit, e thoni,
 5 Im atë më vuri mbë be, dyke thënë, Na unë tek po vdes; ndë varrt t' im, që kam rëmuarë për vetëhenë t' ime ndë dhet të Hanaanit, atje dotë më kallç ndë varr. Tashi pra letë ngjitem, u lutem, e letë kllas ndë varr t' im atë, edhe dotë kthenem prapë.
- 6 Edhe Faraoni tha, Ngjitu, e kall ndë varr të t' atë, sikundrë të vuri mbë be.
- 7 Edhe Josifi ungjit për të kallurë ndë varr t' anë; edhe bashkë me atë ungjitnë gjithë shërbëtorët' e Faraonit, më të-vjetërit' e shtëpis' s' ati, edhe gjithë pleqësia e dheut t' Egjyptësë, Edhe gjithë shtëpia e Josifit, edhe të vëllezërit' e ati, edhe shtëpia e t' et; vetëmë fëmijët' e tyre, e dhënt' e tyre, e lopët' e
 9 tyre, i lanë ndë dhet të Goshenit. Edhe ungjitnë bashkë me atë edhe qerre e kalori,
 10 kaqë sa ubë një shoqëri e-madhe fort. Edhe erdhë ndë lëmët të Atadit, që është përtej Jordanit; edhe atje qanë me ulërimë të-ma-

- dhe e shumë të-keqe; edhe *Josifi* mbajti zi shtatë dit për t' anë.
- 11 Edhe vëndësit' e ati vëndi, Hanaanitëtë, kur panë zinë ndë lëmët të Atadit, thanë, Zi e-madhe *qënëka* këjo për Egjyptianëtë; për-andaj emëri i ati vëndi uquajt Abel-mizraim*), i-cili është përtej Jordanit.
- 12 Edhe të bijt' e ati bënë për atë, sikundrë
 13 i porositi ata; Edhe të bijt' e ati si e prunë ndë dhet të Hanaanit, e kallnë ndë varr ndë shpellët të arës' së Mahpellahut, të-cilënë e bleu Abraami bashkë me arënë për vënt varri nga Efron Hittiti, kundruell Mamrisë.
- 14 Edhe Josifi, passi kalli ndë varr t' anë, ukthye ndë Egjyptë, ay, edhe të vëllezëritë, edhe gjith' ata që ishinë ngjiturë bashkë me atë për të kallurë ndë varr t' anë.
- 15 Edhe të vëllezërit' e Josifit, kur panë se vdiq i at' i tyre, thanë; Mbase Josifi dotë na mbanjë mëri, edhe dotë na i çpaganjë me të-tepërë gjithë sa të-këqia i kemi bërë ati.
- 16 Edhe i dërguanë fjalë Josifit, edhe thanë, Yt
 17 atë urdhëroj që pa vdekurë, edhe tha, Kështu t' i thoni Josifit, Fal, të lutem, paudhërin' e t' ët vëllezërve, edhe fajin' e atyre, sepse të bënë keq. Tashi pra, të lutemi, fal paudhërin' e shërbëtorëvet të Perëndis' së t' yt et.
- 18 Edhe Josifi qau, kur i folnë *këto*. Vanë edhe të vëllezërit' e ati, e i ranë *ndër këmbë* për-
- *) Zia e Egjyptianëvet..

17

18

19

20

21

22

23

24

25

26
